



INTITUCIONET E PËRKOSSHMEVETËQEVERISËSE TË KOSOVËS



Qeveria e Kosovës
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Raport sektorial

Raporti i zhvillimit hapësinor për sektorin e

TREGTISË

Prishtinë, shtator 2004



Draft / dokument pune
Raport i sektorial i zhvillimit hapësinor për sektorin e tregtisë

Zhvillimi hapësinor në fushën e tregtisë

Hartues të draftit / dokumentit punues

Blerim Çerkini, Ekspert lokal i zhvillimit ekonomik, UN-Habitat
Remzi Ahmeti Shef i Divizionit për Tregti të brendshme, MTI, DT
Hysni Terziu, MTI, SPBKP
Selim Thaqi, Konsultant, MEF, DPM
Zana Mehmeti, hulumtuuese profesionale, MMPH, IPH

Prishtinë, shtator 2004



HYRJE

Qëllimi i këtij raporti është që të disponohet me një pasqyrë të qartë mbi gjendjen e sektorit të tregtisë në kuadër të Ekonomisë së Kosovës, pasi Plani hapësinore bazohet ne raportet sektoriale të përgatitura nga Ministrinë përkatëse.

Grupi punues ka tentuar që përmes të dhënave zyrtare të paraqes trendeve të zhvillimit të sektorit të tregtisë në kuadër të Ekonomisë së Kosovës.

PROFILI SEKTORIAL, ÇËSHTJET DHE SFIDAT

Njeri ndër aktivitet kryesore ekonomike ne Kosove gjate këtyre viteve është tregtia.

Shkaqet e një orientimi kaq te madhe te bizneseve ne ketë degë mund të arsyetohet nga fakte te ndryshme duke filluar nga ambienti i cili ekziston për biznese, rregullativa ligjore dhe aspekte tjera të ekonomisë.

Mund te konkludojmë qe tregtia luan një rol shume dominant ne orientimin e zhvillimit ekonomik dhe ne krijimin e vlerës së shtuar

Shikuar numrin e bizneseve te regjistruara sipas seksionit te aktivitetit neper komuna vërehet se numri me i madh i këtyre bizneseve është pikërisht ne sektorin e tregtisë (18064 biznese te regjistruara¹).

Edhe përkundër faktit te një numri kaq te madh te bizneseve te regjistruara ne tregti sa i përket punësimit kjo dege nuk paraqet fuqinë e cila do te duhej ta kishte, pasi qe ne strukturën e tatimeve në paga tregtia merr pjese me nje shkalle me vetëm afër 15% e cila shkalle flet se këto ndërmarrje punësojnë një numër te vogël të punëtorëve.

Pjesëmarrja e tregtisë në strukturën e tatimeve vendore sipas viteve:

Vitet	2000	2001	2002	2003
Përqindja (%)	42.29	47.58	45.70	36.11

Burimi: Ministria e Ekonomisë dhe Financave (Departamenti i Politikave Makroekonomike)

Ne figurën e mësipërme shohim përqindjen e kontributit të kësaj dege të ekonomisë në vlerën e tatimeve te brendshme te cilat janë mbledhur nga Administrata Tatimore.

Vërehet një pjesëmarrje mjaft e lartë e kësaj dege për shkakun qe edhe numri i bizneseve te regjistruara ne këtë dege është i madh.

Pjesëmarrja e numrit te ndërmarrjeve tregtare si tatimpagues ne Administratën tatimore

Vitet	2000	2001	2002	2003
Perqindja (%)	63.03	63.25	63.92	64.71

Burimi: Ministria e Ekonomisë dhe Financave (Departamenti i Politikave Makroekonomike)

Nga këto dhëna shohim qe Tregtia luan nje rol shume domethënës ne strukturën e tatimeve te mbledhura ne Kosove.

Kreditë e dhëna nga bankat komerciale ne sektorin e Tregtisë ne fund te periudhës, në përqindje

Viti	%
2000	70.97
2001	53.67
2002	58.38
2003	48.75

Burimi: Ministria e Ekonomisë dhe Financave (Departamenti i Politikave Makroekonomike)

¹ Ministria e Tregtisë dhe Industrisë „Pasqyrë statistikore mbi bizneset e regjistruara në Kosovë” korrik 2004

Të dhënat mbi kreditë që janë dhënë nga bankat komerciale në sektorin e Tregtisë, tregojnë rritje nga viti në vite ndonëse normat e kamatave dhe afatet e kthimit të kredisë janë shumë të pavoritshme për bizneset tregtare.

Eksporti dhe Importi

Edhe në Kosovë sikurse në vendet tjera të tranzicionit liberalizimi i tregtisë se jashtme u shoqërua me shpërpjesëtime të mëdha ndërmjet eksportit dhe importit.

Bilanci tregtar i Kosovës, në mil. €

	Eksporti	Importi	Bilanci
2000	18.68	635.7	-617.02
2001	10.61	874.5	-863.89
2002	27.32	988.7	-961.38
2003	36.2	968.5	-932.3

Burimi: Shërbimi Doganor i UNMIK-ut dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave (Departamenti i Politikave Makroekonomike)

Rritjes së deficitit tregtar të Kosovës me vendet tjera i kanë kontribuar faktorët:

- Niveli i ulët i prodhimit vendor kundrejt kërkesave të shumta për mallrat e importuara;
- Mungesa e një strategjie të zhvillimit të përgjithshëm ekonomik,
- Statusi ende i padefinuar i Kosovës

Kjo ka ndikuar në nivelin shumë të ulët të mbulimit të importit me eksport: (2000; 2.97%, 2001; 1.22%, 2002: 2.76%, 2003: 3.47%).

Sfidat

- Shpërpjesëtimet aktuale në kornizën makroekonomike të Kosovës (GDP/Konsumi, GDP/Eksporti, Eksporti/Importi) dhe ndikimi negativ i tyre në stabilitetin makroekonomik,
- Deficiti Ekstrem tregtar, si rezultat i nivelit të ulët të eksportit në raport me rritjen e lartë të importit,
- Ndikimi i politikave tregtare asimetrike në këmbimin tregtar të Kosovës me vendet e rajonit,
- Ndikimi i një numri të madh të pengesave në relacionet: zhvillimi i sektorit private – NVM – Bashkëpunimi tregtar dhe eksporti – investimet e huaja dhe pengesat që kanë të bëjnë me privatizimin ,
- Iniciativat ndërkombëtare (Pakti i stabilitetit) për krijimin e një zone të tregtisë së lire në EJT nëpërmjet nënshkrimit të MTL-ve, duke pasur parasysh inkuadrimitin e Kosovës në këtë proces,
- Nevojën për sensibilizimin e opinionit dhe sidomos të bartësve të politikave ekonomike për rolin dhe rëndësinë e eksportit në rritjen ekonomike dhe në krijimin e qëndrueshmërisë ekonomike në përgjithësi.

VLERËSIMI DHE ORIENTIMET, UDHËZIMET POLITIKE

SWOT Analiza për sektorin e tregtisë

S- Përparësitë

- Pozita e mirë gjeostrategjike për tregti
- Liberalizimi i tregut dhe tregtisë
- Infrastruktura e volitshme për tregti me shumicë dhe pakicë
- Pjesëmarrje e lartë e tregtisë në BPV
- Profit i lartë
- Kushte te volitshme (kapacitet fizike për aktivitet tregtare)
- Tarifat e ulta doganore për mjete kapitale, lëndë të parë dhe gjysmëfabrikate në lëmin e bujqësisë
- Nismat e privatizimit për subjektet tregtare
- Zhvillimi i tregtisë përmes transportimit të ndryshëm
- Preferenca për eksportimin e disa produkteve në tregjet e BE

W - Dobësitë

- Bilanci tregtar negativ (export – import)
- Infrastruktura e pa kompletuar ligjore për tregti
- Mungesa e përvojave bashkëkohore në tregti
- Politikat fiskale dhe kreditore të pavolitshme
- Promovim i dobët në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare
- Konkurrenca jo lojale në tregun vendorë
- Mosfunksionim i organeve të mbikëqyrjes për kontroll të kualitetit në tregun vendorë
- Prezenca e evazionit fiskal në shkallë të lartë

O - Mundësitë

- Mundësitë e zgjerimit me asortimente të reja për eksport në tregjet e BE-së
- Anëtarësimi në Organizatën Botërore të Tregtisë së lirë (OBT)
- Nënshkrimi i marrëveshjeve të reja për tregti të lirë
- Mundësitë e integritimeve bilaterale dhe multilaterale


T – Rreziqet

- Statusi ende i padefinuar
- Vonesat e mundshme në privatizim
- Pamundësia e kyçje në Fondin Monetarë Ndërkombëtarë dhe institucionet tjera monetare
- Vonesat në transicionin ekonomik dhe politikë

Vlerësime rreth pjesëmarrjes se tregtisë në BPV

Ekzistojnë vlerësime për pjesëmarrjen e tregtisë në Bruto Produktin Vendore.

Sipas një vlerësimit të Departamentit të Politikave Makroekonomike pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave vlerësohet se pjesëmarrja e Tregtisë në BPV gjate vitit 2002 ishte 47.12% dhe në vitin 2003 47.71%.²



Burimi: Ministria e Ekonomisë dhe Financave (Departamenti i Politikave Makroekonomike)

Është dukuri jo e mirë një pjesëmarrje kaq e lartë e tregtisë në GDP, pasi që asnjë vend nuk mund të bazoi zhvillimin ekonomik në tregti, mirëpo në këtë rast tregtia do të ndihmoi në masë shumë të madhe në rritjen e kapaciteteve prodhuese brenda vendit nëpërmjet krijimit të lidhjeve me vendet tjera dhe ofrimit të produkteve të nevojshme me çmime më të ulëta të cilat do të shërbejnë degëve prodhuese në ekonomi.

Por kjo pjesëmarrje kaq e lartë e Tregtisë në BPV është shumë e kuptueshme kur kthehet parasysh fakti se numri më i madh i bizneseve të regjistruara janë pikërisht në tregti.

² MEF Departamenti i Politikave Makroekonomike „Bruto Produkti vendore sipas sektoreve“ 2004

QËLLIMET DHE PRIORITETET NË SEKTORIN E TREGTISË

Qëllimet

a. Ndryshimet në strukturën e importit:

- Orientimi në import të mjeteve kapitale, lende të pare dhe gjysmefabrikate të domosdoshme për riprodhim të zgjeruar
- Orientimi i prodhimit vendor për eksport

b. Politikat ekonomike:

- Caktimi i prioriteteve sektoriale prodhuese,
- Politikat fiskale më të favorshme për prodhim
- Stimulimi i prodhimit vendor përmes politikave më të favorshme kredituese
- Infrastruktura e favorshme ligjore për tërheqjen e investimeve dhe investitorëve

Prioritetet

a. Liberalizimi i tregtisë përmes:

- Lidhja e MTL-ve me vendet fqinje dhe vendet në regjion
- Inkuadrimi i Kosovës në OBT (Org. Bot. e Tregtisë),
- Përafrimi i infrastrukturës ligjore dhe kushteve të tjera për inkuadrim në BE

b. Mekanizmat e zbatimit dhe mbikëqyrjes

- Themelimi i institucioneve relevante qeveritare për zbatimin e orientimeve ,
- Agjencisë për Promovim të Eksportit,
- Agjencisë për Kreditim të Eksportit,
- Agjencisë për Promovim të Investimeve,
- Agjencisë për Standardizim ,etj.

c. Themelimi i organeve mbikqyrese:

- Inspekcioni i Tregut,
- Inspeksionet Sanitare dhe Fito-sanitare,
- Këshilli për Konkurrence,
- Shoqatat lokale dhe qendrore për mbrojtje të konsumatorit si dhe zgjerimi i kapaciteteve institucionale qendrore për mbikëqyrjen dhe zbatimin e orientimeve.

Prioritetet strategjike dhe zonat e veprimit

- Hartimi i Strategjisë së Zhvillimit të Tregtisë
- Pozicionimi dhe definimi i kapaciteteve tregtare ekzistuese sipas modeleve dhe kërkesave të shteteve të zhvilluara të BE-së
- Definimi – pozicionimi i tregtisë në zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomikë e me theks të veçanta në relacionin prodhim - tregti

LISTA E PROJEKTEVE NE ZBATIM

- Themelimi i Inspeksioni te Tregut,
- Përgatitja e infrastrukturës ligjore për tregti,
- Përcjellja e këmbimit tregtar të Kosovës me vendet e tjera,
- Përcjellja e zbatimit te MTL-se Kosove – Shqipëri,
- Mbrojtja e konsumatorit,
- Konkurrenca ne tregun vendor,
- Përcjellja e çmimeve në tregun vendor, etj.
- Parqet e biznesit

DOKUMENTACIONI EKZISTUES, LISTA E MATERIALEVE

1. Strategji te zhvillimit afatmesëm të ekonomisë së Kosovë
2. Pasqyre statistikore mbi bizneset e regjistruara në Kosove (MTI)
3. Memorandumi Ekonomikë i Kosovës (BB)
4. Monitori Mujor Makroekonomik (MEF)
5. Pasqyra e këmbimit tregtar të Kosovës me vendet e tjera (ShDU)

SHKURTESAT

BPV	(GDP) Bruto Produkti Vendorë
MTI	Ministria Tregtisë dhe Industrisë
MEF	Ministria Ekonomisë dhe Financave
BB	Banka Botërore
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe te Mesme
EJL	EJL Evropa Juglindore
SHDU	Shërbimi Doganor i UNMIK-ut
MTL	Marrëveshja e Tregtisë se Lirë
OBT	Organizata e Tregtisë se Lirë
BE	Bashkësia Evropiane